



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES

KESHILLI I BASHKISE VAU DEJES

Nr./163 Prot.

Vau Dejes me 20.03.2023

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore" neni 18 pika 1 dhe pika 2, neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funksonimin e Keshillit Bashkiak Vau Dejes (VKB 23/2020) neni 154:

Keshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Stajke dhe Shelqet (të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Bushat dhe Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 2590 m², pjesë e pasurisë nr.357/2, Zk nr.3334 dhe pasurisë nr.546/4 Zk nr.3506 e llojit " Pa fryt ", në fshatin Stajkë-Shelqet, Bashkia Vau Dejës.

(Paraqitur nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Integritimit Sektori Aseteve.)

Degjesa publike do të bëhet me datë 20.03.2023 ora 10.00 fshati Stajkë-Shelqet.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al, ardian.celepija@vaudejes.gov.al, facebook - Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI KESHILLIT

Ardian Celepija





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
Sektori i Aseteve

Nr 1162 Prot.

Vau Dejës me 20 . 02 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z. Mark Bisha
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar z. Kryetar

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Vendimin.

“Dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 2590 m², pjesë të pasurive nr 357/2, Zk nr 3334, dhe nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, ndodhur perkatesisht në fshatin Shelqet dhe Stajkë, Bashkia Vau Dejës.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë:

1. Projekt vendimi
2. Relacioni
3. Kopje e kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe fragment të hartës kadastrale, për pasurinë nr 357/2, Zk nr 3334.
4. Kopje e çertifikatës së pronësisë për pasurinë nr 546/4, Zk nr 3506.
5. Plan rilevimit e pasurisë.

KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELI



Konceptoi: Ndoc Baqli

Datë: _____

Nr faqeve A4 të projekt-propozimit _____

Nr faqeve A4 të dokumenteve që shoqërojnë projekt-vendimin _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

PROJEKT VENDIM

Nr _____ Date _____ 2023

Dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 2590 m², pjesë e pasurisë nr 357/2, Zk nr 3334, dhe pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506 e llojit “Pa fryt”, në fshatin Stajkë-Shelqet, Bashkia Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1”(ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vëtëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr 1423 datë 10.10.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut të Shkodrës”, në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 54 dt 05.02.2014,”Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, që në mbledhjen e radhës të:


VENDOSI

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit, të sipërfaqes prej 2590 m², e llojit “Pa Fryt”, me afat deri 10 vjet, e cila gjendet në kufirin e dy zonave kadastrale, sipas plan rilevimit bashkëlidhur, përkatësisht sipërfaqja prej 2100 m², që është pjesë e pasurisë nr 357/2, Zk nr 3334, fshati Shelqet, dhe sipërfaqja prej 490 m², që është pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, fshati Stajkë, pronë e Bashkisë Vau Dejës.
Kjo pasuri lejohet të jepet në përdorim për ushtrimin e veprimtarive ekonomike në fushën e bujqësisë, blegtorisë, në fushën e agropërpunimit, industrisë etj.
2. Efektet: Jep efekte pozitive në komunitet, duke hapur vende te reja pune si dhe duke siguruar të ardhura për Bashkinë, të cilat kthehen më pas në investime publike.

3. Vlera dysHEME vjetore e dhënies me qira të jetë e bazuar në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
4. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me procedurat e konkurimit, shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe më pas me hapat e mëtejshëm të procedurës, me të gjithë elementet përbërës të saj, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELI



Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

RELACION

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISË SHTETËRORE E LLOJIT “PA FRYT” ME SIPËRFAQE PREJ 2590 M2, NË FSHATIN STAJKE-SHELQET, BASHKIA VAU DEJËS

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe ruajtjen e tokave dhe kategorive të tjera të resurseve si toka te pafrytshme etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në administrim të saj, me qëllim dhënien në përdorim me anë të konkurimit, të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire. Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i asetëve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr 8744 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar, bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në administrim të saj, me kontratë qiraje, duke zhvilluar procedurën përkatëse të konkurimit me të gjithë elementët përbërës të saj.

Bazuar në kartelën e pasurisë së paluajtshme ardhur nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, pasuria nr 357/2, Zk nr 3334, ndodhur në fshatin Shelqet, është e llojit “Pa fryt”.

Gjithashtu edhe pasuria nr 546/4, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë, është me çertifikatë pronësie, kopje të së cilës e gjeni bashkëlidhur, dhe është e llojit “Pa fryt”.

Bazuar në udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar, kategoria e tokave të llojit “Pa fryt”, lejohen të përdoren për qëllime bujqësore, blegtorale dhe agropërpunimi, sipas paraqitjes së plan biznesit të subjektit konkurues që shpallet fitues.

Vlera dysheme e qirasë vjetore për fillimin e konkurimit sipas Udhëzimit nr 13, datë 18.04.2018, dhe VKM-së së mësipërme, për tokat e pafrytshme, është jo më e ulët se 27 000 leke/Ha në vit.

Sipërfaqja prej 2590 m2, që propozojmë të jepet me qira me anë të konkurimit është pjesë e dy pasurive në dy kufi të dy zonave kadstrale, përkatësisht sipërfaqja prej 2100 m2, pjesë e pasurisë nr 357/2, Zk nr 3334, ndodhur në fshatin Shelqet, Bashkia Vau Dejës, e cila në kartelën e pasurisë së paluajtshme, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, rezulton pronësia Shtet, e llojit Pa fryt, si dhe sipërfaqja prej 490 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë, me çertifikatë pronësie, e llojit "Pa fryt".


Pas miratimit në KB dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut, do bëhet shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe procedurën e mëtejshme me të gjithë elementët përbërës të saj deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

Duke ju falenderuar.

Hartuesit e relacionit

Ndoc Baqli



Armand Filipi



Arjeta Garubi



KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELI



PLAN RILEVIMI

PERGATITI

HAMID ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e përgatitjes. 15.09.2021

SIPERFAQE TOTALE

Sip= 2590 m²

PASURIA 357/2 S= 2100 m²
PASURIA 546 S= 490 m²

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3334, 3506

NR PASURISE 357/2, 546 VOL FAQE

SHKALA 1:2500

INDEKSI I HARTES : K - 34- 76 -(4 -C)

ADRESA E PASURISE

RRETHI: SHKODER FSHATI: SHELQET-STAJKE

POROSITES: MARE ADRIATIK SHPK

